

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

Kroatët e Kosovës në Komunën e Vitisë/Vitina:
Komunitet i cënueshëm

Tetor, 2011

Mohim përgjegjësie:

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
1. HYRJE	1
2. SITUATA SOCIO-EKONOMIK DHE QASJA NË SHËRBIME	2
3. PJESËMARRJA NË ÇËSHTJET PUBLIKE	5
4. ÇËSHTJET PRONËSORE	7
4.1. Regjistrimi i pronës	8
4.2. Administrimi i pronës	9
5. SIGURIA DHE LIRIA E LËVIZJES	10
6. PËRFUNDIM	11
7. REKOMANDIME	12

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) është i shqetësuar për situatën e komunitetit të vogël kroat të Kosovës që jeton në komunën e Vitisë/Vitina, në rajonin e Gjilanit/Gnjilane. Ky raport dokumenton shkeljet e drejtave pronësore dhe paraqet një pasqyrë shqetësuese të gjendjes së pasigurt socio-ekonomike me të cilën përballlet ky komunitet. Raporti thekson çështjet që kanë të bëjnë me shqetësime të vazhdueshme të sigurisë, injorim të perceptuar dhe/apo të vërtetë institucional, si dhe mungesë të pjesëmarrjes në çështjet publike të cilat kanë kontribuar në krijimin e një ndjenje të thellë të izolimit të ky komunitet i kroatëve kryesisht të moshuar të Kosovës. Situata e vështirë e komunitetit kërkon veprime të menjëhershme nga institucionet përkatëse publike, posaçërisht në nivel komunal. OSBE-ja rekomandon që komuna t'i ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm për fuqizimin e funksionalitetit e mekanizmave përkatës të obligueshëm për pjesëmarrje të komuniteteve, të kontakton rregullisht me komunitetin, si dhe të përmirësojë qasjen e komunitetit në shërbimet themelore siç janë kujdesi shëndetësor dhe shërbimet komunale.

1. HYRJE

Komuniteti i kroatëve të Kosovës banon në fshatrat Letnicë/Letnica, Shashar/Šašare, Vërnavokollë/Vrnavokolo dhe Vërnez/Vrnez¹ në komunën e Vitisë/Vitina (rajoni i Gjilanit/Gnjilane), duke përbërë rreth 0.05% të popullatës.² Kroatët e Kosovës gjithashtu jetojnë në fshatin e Janjevës/Janjevo në komunën e Lipjanit/Lipljan (rajoni i Prishtinës/Priština), ku përbëjnë rreth 0.29% të popullatës së komunës.³ Nga 4,331 kroatë të Kosovës të regjistruar në komunën e Vitisë/Vitina në regjistrimin e popullsisë së vitit 1991⁴, në vitin 2011 kanë mbetur vetëm rreth 40 syresh. Shumica e kroatëve të Kosovës nga Vitia/Vitina kanë ikur nga Kosova gjatë viteve të 1990-ta dhe gjatë konfliktit të vitit 1999, duke ikur nga pasiguria gjithnjë e më e madhe si dhe mungesa e mundësive ekonomike.⁵ Shumica dërmuese e kroatëve të Kosovës janë zhvendosur në Kroaci, ku fillimisht ishin strehuar në qendra kolektive dhe gradualisht kanë fituar banim social. OSBE-ja është në dijeni të vetëm katër kthimeve të kroatëve të Kosovës në Letnicë/Letnica që prej vitit 1999, që ka bërë që institucionet komunale

¹ Për të qenë të saktë në referencat e lokacioneve gjeografike, fshatrat e shqyrtuara në këtë raport do të referohen si “rajoni i Letnicës/Letnica” duke i përfshirë fshatrat Letnicë/Letnica, Shashar/Šašare, Vërnavokollë/Vrnavokolo dhe Vërnez/Vrnez, përveç nëse konsiderohet e rëndësishme në kontekst që të përmendet një fshat specifik. Një numër i vogël i kroatëve të Kosovës jetojnë në fshatin Bincë/Binač (komuna e Vitisë/Vitina); ata nuk janë të përfshirë në këtë raport.

² Raporti i OSBE-së *Profilet e Komuniteteve të Kosovës* (2010), “Profili i Komunitetit Kroat të Kosovës”, faqe 119. <http://www.osce.org/kosovo/75450> (qasur më 4 maj, 2011). Shifrat bazohen në vlerësime të përafërta të siguruar nga përfaqësues të komunitetit dhe zyrtarë komunalë për OSBE-në.

³ Po aty. Kroatët e Kosovës në komunën e Lipjanit/Lipljan vuajnë shumë nga mungesa e mundësive socio-ekonomike, por jo më shumë se komunitetet tjera në komunë. Qëllimi i këtij raporti është të theksohen çështjet me të cilat përballlet komuniteti kroat i Kosovës në komunën e Vitisë/Vitina, të cilët janë posaçërisht të cenueshëm dhe të marginalizuar.

⁴ Po aty. Të dhënat e grumbulluara për regjistrimin e popullsisë së vitit 1991 janë të diskutueshme, meqë janë bojkotuar nga segmente të popullatës.

⁵ Për një analizë më gjithëpërfshirëse për çështjet e ndryshme që prekin komunitetin kroat të Kosovës, ju lutem lexoni *Profilet e komuniteteve të Kosovës*. Po aty.

dhe hisedarët e tjerë të kenë qëndrim pasiv drejt hulumentit të kthimeve të tjera të mundshme.

Shumica e popullatës së mbetur të kroatëve të Kosovës janë të moshuar, dhe në mungesë të anëtarëve më të ri të familjes, ata mbështeten në mirëqenie sociale për mbijetesë. Sipas monitorimit në terren të OSBE-së, ky komunitet i cenueshëm dhe i izoluar jeton në varfëri të skajshme dhe në kushte të papërshtatshëm të banimit. Rreth 200 shqiptarë etnikë nga ish Republika Jugosllave e Maqedonisë kanë uzurpuar shtëpitë e braktisura të kroatëve të Kosovës gjatë periudhës së konfliktit të vitit 2001 në IRJ të Maqedonisë, dhe që atëherë ato shtëpi vazhdojnë të jenë të uzurpuara. Arritja e tyre ka nxitur tensione me banorët kroatë të Kosovës dhe konflikte mbi zotërimin e pronave bujqësore dhe banesore të cilat komunitetet nuk kanë arritur t'i zgjidhin. Mungesa e veprimeve nga ana e autoriteteve kompetente për t'i mbrojtur të drejtat private pronësore apo për të ndërmjetësuar në konteste të tilla ka çuar në rritje të perceptimit të kroatëve të Kosovës të një injorimi institucional, si dhe në përkeqësim të tensioneve ndërmjet komuniteteve në këtë rajon.

Pas një rritjeje të numrit të incidenteve të sigurisë⁶ që preknin komunitetin dhe të raportuara në polici gjatë gjysmës së dytë të vitit 2010 dhe pretendimeve të vazhdueshme të injorimit të autoriteteve komunale ndaj komunitetit, OSBE-ja ka intensifikuar aktivitetet e saja të monitorimit dhe avokimit në këtë rajon me qëllim të përmirësimit të të drejtave të komunitetit kroat të Kosovës.

Metodologjia e shfrytëzuar për grumbullim të të dhënave ka përfshirë intervista individuale dhe grupe me pjesëtarë të komunitetit, monitorim në terren, shqyrtim të dokumenteve gjyqësore dhe ligjore të ofruara nga komuniteti në lidhje me çështjet pronësore, si dhe intervista me zyrtarë përkatës nga institucionet lokale dhe organizatat ndërkombëtare.⁷

Rezultatet e këtij procesi janë ilustruar në këtë raport, i cili shqyrton situatën aktuale të komunitetit kroat të Kosovës në Viti/Vitina, si dhe vlerësojnë gëzimin e të drejtave dhe lirive të tyre në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale, pjesëmarrjen në çështje publike, të drejta pronësore, si dhe sigurinë dhe lirinë e lëvizjes.

2. SITUATA SOCIO-EKONOMIK DHE QASJA NË SHËRBIME

Shumica e kroatëve të Kosovës në rajonin e Letnicë/Letnica janë të moshuar. Shumë janë të ve dhe të veja, që jetojnë vetëm në shtëpitë të cilat janë në gjendje të mjerueshme, shpeshherë pa banja dhe kuzhina. Hapësira e banimit zakonisht përbëhet nga vetëm një dhomë me krevat, furrë dhe tryezë, zakonisht me dysheme druri, ndërsa pjesa tjetër shfrytëzohet si magazinë apo është e zbrazët. Kopshtet dhe toka përreth është e mbuluar me bari dhe nuk shfrytëzohet për shkak të moshës së vjetër dhe palëvizshmërisë fizike të shumë prej banorëve.

⁶ Incidentet e sigurisë kryesisht përfshijnë ngacmime gojore dhe fizike, por edhe uzurpimin e tokës dhe frikësimin. Shih pjesët 4 dhe 5 për më shumë hollësi.

⁷ Të dhënat për këtë raport janë grumbulluar nga OSBE-ja në mënyrë intensive ndërmjet korrikut dhe tetorit 2010, ndërsa intervistat me përfaqësues të komunitetit dhe zyrtarë janë kryer ndërmjet 1-30 tetorit 2010. Të dhënat shtesë janë grumbulluar përmes monitorimit të rregullt të OSBE-së në takime të organeve komunale dhe forumeve të sigurisë në nivel lokal. Informatat janë azhurnuar për të gjitha çështjet deri në korrik 2011, duke mbuluar edhe korrikun.

Mundësitë për gjenerim të të ardhurave janë shumë të kufizuara. Nga rreth 40 kroatët e mbetur në rajonin e Letnicës/Letnica, vetëm katër persona janë të aftë për punë, nga të cilët vetëm dy fitojnë të ardhura të qëndrueshme nga një restorant i menaxhuar nga familjarët. Dy të tjerët kujdesen për bagëti dhe prodhojnë produkte qumështi dhe mishi për konsum vetanak, meqë nuk janë në gjendje t'i shesin produktet e tyre jashtë vendbanimit për shkak të lirisë së kufizuar të lëvizjes (e shtjelluar më poshtë). OSBE-ja ka vërejtur dy raste të ish-punonjësve në ndërmarrje shoqërore të cilët nuk janë përfshirë në listën e personave të kualifikuar për të përfituar nga privatizimi i ndërmarrjes së tyre, që do të kishte pasur mundësi të jetë burim i të ardhurave, duke i privuar ata nga burimi i të ardhurave shtesë.⁸ Të gjithë kroatët e Kosovës mbi moshën 65 vjeçe që jetojnë në këtë rajon kualifikohen dhe pranojnë pensionin bazik në Kosovë, gjersa po ashtu pranojnë edhe pensione nga Serbia dhe, në një rast, nga Gjermania. Gjithashtu, kanë qenë shtatë përfitues të skemës kosovare për ndihmë sociale.⁹ Ky komunitet pranon edhe ndihmë humanitare nga dega e Kryqit të Kuq serb në fshatin e afërm me shumicë serbe Vrbovac/Vërboc (komuna e Klllokotit/Klokot), dhe nga kisha e afërt katolike.

Qasja në shërbime të kujdesit shëndetësor është e kufizuar¹⁰ për shkak të lëvizshmërisë së kufizuar të komunitetit, mungesës së transportit adekuat publik dhe distancave të gjata deri te qendra shëndetësore më e afërt (të cilat janë në komunat fqinje, apo edhe më larg varësisht nga serioziteti i sëmundjes)¹¹. Kostoja e trajtimit dhe ilaçeve parashtron një pengesë shtesë në gëzimin e të drejtave të tyre në shërbime adekuate shëndetësore. Disa nga pjesëtarët më të vjetër dhe më të cënueshëm të komunitetit kanë nevojë për kujdes shtëpiak; megjithatë, përveç një rasti, këta individë kujdesën nga pjesëtarët e tjerë të komunitetit apo kisha e afërt katolike.¹² Kjo e fundit aktualisht është duke e shtjelluar mundësinë e ndërtimit të një shtëpie të pleqve për t'i shërbyer nevojave gjithnjë në rritje të komunitetit, ndonëse nuk i

⁸ Të dy ish-punonjësit pretendojnë se i kanë përmbushur kriteret dhe, me ndihmën e OSBE-së, kanë parashtruar ankesë zyrtare në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP). Agjencisë Kosovare të Privatizimit i është besuar shitja, transferimi dhe/apo likuidimi i ndërmarrjeve dhe asetëve në pronësi shoqërore. Deri në fund të korrikut 2011, ankuesit nuk kanë pranuar përgjigje në ankesën e tyre zyrtare të dorëzuar më 30 tetor 2010.

⁹ Informatat janë ofruar nga Drejtori i Qendrës për Mirëqenie Sociale në Viti/Vitina, gjatë periudhës së intervistimit. Shih shënimin 7 më lart.

¹⁰ Qasja e barabartë në kujdes shëndetësor është e garantuar me nenin 7.1 të Ligjit nr. 03/L-124 për Ndryshimin e Ligjit për shëndetësinë, 30 dhjetor 2008, që përcakton se “sistemi i kujdesit shëndetësor duhet të jetë i qasshëm [...] të gjitha komunitetet” e Kosovës, gjersa përgjegjësia kryesore për të siguruar këtë qasje bie në departamentin e shëndetësisë së komunës relevante. Veç kësaj, ligji përcakton që të gjithë kanë të drejtë në “shpërndarje të barabartë të resurseve të kujdesit shëndetësor bazuar në barazinë sociale dhe ekonomike”, ndërsa kujdesi shëndetësor do të ofrohet pa pagesë për “shtetasit mbi moshën 65 vjeçe” dhe për “personat me aftësi të kufizuara”.

¹¹ Në qershor 2011 komuna e Vitisë/Vitina ka shpallur një projekt për rehabilitimin e klinikës shëndetësore në fshatin Letnicë/Letnica. Projekti do të financohet kryesisht nga Qeveria Kroate me disa fonde të furnizuara nga komuna dhe të realizuara nga USAID-i. Projekti pritet të përfundojë në fund të vitit 2011.

¹² Neni 1 i Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime sociale dhe familjare, i shpallur me Rregullore të UNMIK-ut nr. 2005/46, 14 tetor 2005, parasheh ofrimin e shërbimit të tillë për “personat në nevojë”, duke përfshirë personat “në moshë të shtyrë” dhe/apo personat që vuajnë nga “sëmundje apo paafësi fizike” përmes Qendrave për Punë Sociale. Drejtori i Qendrës për Punë Sociale në Viti /Vitina thekson që këto shërbime ofrohen te të gjitha komunitetet në mënyrë të barabartë, në pajtim me nevojat e banorëve individualë. Aktualisht, shërbimet e kujdesit shëndetësor shtëpiak ofrohen për një familje kroate të Kosovës në fshatin Vërnavokollë/Vrnavokolo.

posedon mjetet financiare për ta realizuar këtë projekt. Komuna e Vitisë/Vitina është në dijeni në për këtë rast dhe Drejtori Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka ndarë me OSBE-në një plan për ndërtimin e një institucioni në Letnicë/Letnica. Megjithatë, Drejtori ka theksuar se nuk ka buxhet komunal për financimin e projektit dhe nuk ka plane konkrete. Hapi i vetëm konkret i ndërmarrë nga komuna për trajtimin e këtij shqetësimi është vendimi për mbështetje financiare në baza ad hoc, rastin e një kroati të shtrirë të Kosovës përmes sistemimit të tij nën kujdes.

Komuniteti kroat i Kosovës në rajonin e Letnicës/Letnica gjithashtu është përballë me sfida të rënda në qasjen e tyre në ujë të pijshëm.¹³ Sistemi ekzistues i ujësjellësit është financiar nga komuniteti dhe është i ndërtuar para se më shumë se 30 viteve. Më 2007 kompania rajonale e ujësjellësit, “Hidromorava”, ka bërë një vlerësim të sistemit të tubave dhe ka raportuar se duhen të zëvendësohen tërësisht. Deri në mes të vitit 2011 komuna kishte deklaruar se nuk ka mjete për financim të punëve, por megjithatë, në korrik 2011 kanë paralajmëruar një projekt për riparimin e pjesës së sistemit kryesor të ujësjellësit në Letnicë/Letnica dhe Shashar/Šašare, punë të cilat janë përfunduar në fund të korrikut 2011. Qasja në ujin e pakët, për përdorim personal por edhe për ujitje të arave ka nxitur tensione ndërmjet kroatëve dhe shqiptarëve të Kosovës. Sipas përfaqësuesit të kroatëve të Kosovës në Letnicë/Letnica burimi i vetëm publik i ujit në fshat është devijuar nga një shqiptar etnik i ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë që kishte uzurpuar disa shtëpi të braktisura të kroatëve të Kosovës dhe arën e afërme. Ai deklaroi se, për shumë banorë, ky ishte burimi i vetëm i ujit të pijshëm në afërsi. Ky rast është raportuar në policinë e Kosovës, mirëpo mungesa e dokumenteve të pronësisë në këtë rajon e vështirësoi punën e tyre në ndjekjen e këtij rasti. Në ndërkohë, banorët kroatë të Kosovës në fshat kanë zhvilluar tubacionin e tyre të ujit në qendër të fshatit për të siguruar një shkallë të qasjes në furnizim me ujë. Sipas priftit lokal të Kishës Katolike dhe përfaqësuesve të komunitetit, kjo është për shkak të nevojës për riparime në rrjetin sekondar të furnizimit me ujë, kombinuar me konsumin e lartë të ujit nga ish ndërmarrja shoqërore tanimë e privatizuar në këtë rajon, e cila po ashtu është e lidhur në sistemin e ujit.

Situata është po aq e pasigurt në qasjen e komunitetit në energji elektrike, ku ka ndërprerje të shpeshta të rrymës. Mungesa e energjisë elektrike, posaçërisht në muajt e dimrit, ka pasur ndikim të konsiderueshëm negativ në mirëqenien e këtij komuniteti të moshuar të kroatëve të Kosovës. Ndonëse furnizimi me rrymë është kompetencë primare të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) në pronësi publike, institucionet komunale kanë rol të rëndësishëm në rregullimin e planifikimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, në bashkëpunim të ngushtë me KEK-un.¹⁴ Shkycjet vijnë si pasojë e mospagesës së faturave. Në lidhje me këtë, udhëheqësi i KEK-ut në Viti/Vitina ka deklaruar se shumica e mospaguesve janë shqiptarë etnikë nga ish Republika Jugosllave e Maqedonisë që kanë uzurpuar shtëpitë e kroatëve të Kosovës. Më tej, ai i prezantoi OSBE-së listën e 10 kroatëve të Kosovës të cilët kishin paguar faturat e tyre

¹³ Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, 15 qershor 2008, përcakton në nenin 17.1.f, se ofrimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve publike, duke përfshirë furnizimin me ujë, është përgjegjësi e autoriteteve komunale.

¹⁴ Shih nenin 23 të Ligjit nr. 03/L-201 për Energjinë elektrike, 25 tetor 2010, që përcakton se “çdo konsumator i ekonomisë familjare ka të drejtë në furnizim me energji elektrike”, gjersa neni 16.1.13 i të njëjtit ligj përcakton se “operatori i sistemit të shpërndarjes” (në këtë rast KEK) “harton planet të sistemit të shpërndarjes në koordinim me komunat”.

në tetor 2010, por edhe raste e gjashtë kroatëve të cilët janë në skemën e mirëqenies për të cilët Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ende nuk ka subvencionuar asnjë faturë të energjisë elektrike.¹⁵

Një aspekt i rëndësishëm i gëzimit të qasjes së barabartë në shërbime komunale dhe shërbime tjera lidhet me aftësinë e komunitetit për të komunikuar me ofruesit e shërbimeve në njërën nga dy gjuhët zyrtare të Kosovës (shqip dhe serbisht), e drejtë e garantuar me ligj.¹⁶ Kroatët e Kosovës në diskutimet e tyre me autoritetet publike përdorin gjuhën serbe dhe pjesëtarët e komunitetit janë ankuar në OSBE se zyrtarët komunalë në disa raste kanë refuzuar të flasin serbisht dhe/apo nuk kanë arritur të ofrojnë përkthim. Këto pohime janë kryesisht në lidhje me zyrat kadastrorë komunale, ndonëse një ankues është raportuar se në një rast vendimi i prokurorit publik për të hedhur poshtë një rast të ngritur nga një banor kroat i Kosovës nga fshati Šašare/Shasarë në lidhje dëmet në varrezat katolike në fshat është shkruar dhe dorëzuar vetëm në gjuhën shqipe.¹⁷

Një shembull tjetër i papajtueshmërisë me Ligjin për përdorimin e gjuhëve është se të gjitha shenjat zyrtare në ndërtesën komunale janë vetëm në gjuhën shqipe dhe jo në të dy gjuhët siç kërkohet me ligj. Kreu i administratës komunale dhe burimeve njerëzore i ka raportuar OSBE-së se nuk kanë pranuar asnjë ankesë në komunë¹⁸ dhe pjesëtarët e komuniteteve joshumicë pranojnë shërbime në gjuhën e tyre nëse ato kërkohen.¹⁹ Vendosja e shenjave zyrtare dygjuhëshe brenda ndërtesës komunale dhe sigurimi i stafit serbfolës apo përkthyesve do të lehtësonte në masë të madhe qasjen e komunitetit kroat të Kosovës në shërbimet komunale dhe do të trajtonte perceptimin e komunitetit të trajtimit të pabarabartë dhe injorimit institucional.

3. PJESËMARRJA NË ÇËSHTJET PUBLIKE

Ekziston një mungesë e përgjithshme e pjesëmarrjes së komunitetit kroat të komunës së Vitisë/Vitina në çështjet publike, në veçanti e kroatëve të rajonit të Letnicës/Letnica. Nuk ka përfaqësim në degët legjislative apo ekzekutive të komunës së Vitisë/Vitina dhe asnjë nga katër pjesëtarët e komunitetit të moshës së punës

¹⁵ Sipas një marrëveshjeje të vitit 2009 ndërmjet Ministrit për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe KEK-ut, ekonomitë familjare që kualifikohen si ‘raste sociale’ janë të kualifikuara në subvencione të energjisë elektrike nga ana e Ministrisë, që mund të arrijë shumën deri në 240 Euro në vit. Megjithatë, Ministria enda nuk ka realizuar pagesa të tilla.

¹⁶ Shih nenin 7.2 të Ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e gjuhëve, 20 tetor 2006.

¹⁷ Shih Kodin e përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës të shpallur me Rregullore të UNMIK-ut nr. 2003/26, 6 korrik 2003 me ndryshimet pasuese. Më 22 dhjetor 2008, Kosova ka shpallur Ligjin nr. 03/L-003 për Ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të Procedurës Penale nr. 2003/26 i cili nuk ka bërë ndryshime substanciale në kod krahasuar me ligjin e vitit 2003, ndonëse është shtuar një pjesë për marrëveshjet për deklarim të fajësisë, është ndryshuar një nen për kohëzgjatjen e periudhës së paraburgimit policor, si dhe titulli i kodit është ndryshuar në Kodi i Procedurës Penale të Kosovës. Nenet 15 dhe 219 të këtij Kodi parashohin përdorimin e tri gjuhëve zyrtare në procedurat e gjykatës. Legjislacioni përcakton që gjuhët e punës së gjykatës janë shqipja dhe serbishtja, por krahas kësaj duhet të ofrohet përkthimi në anglisht, nëse kërkohet për një lëndë specifike.

¹⁸ Ekzistojnë një varg metodash për parashtrimin e ankesave, duke përfshirë përmes Komitetit për Komunitete, Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete, apo Komisionit të Gjuhëve.

¹⁹ Ankesa të ngjashme për përdorimin e gjuhëve nga ana e autoriteteve komunale të Vitisë /Vitina janë ngritur edhe nga komuniteti serb i Kosovës që banon në komunë.

aktualisht nuk janë të punësuar në shërbimin civil të komunës. Forumi i vetëm publik ku komuniteti ka marrë pjesë ishte ish Këshilli Lokal për Siguri në Bashkësi (KLSB) në Vrbovac/Vërboc.²⁰ Megjithatë, pas themelimit të komunës së re të Kllokotit /Klokot në janar 2010, fshatrat e kroatëve të komunës së Vitisë/Vitina kanë mbetur jashtë KLSB-së, duke çuar në largimin e përfaqësuesit të komunitetit të tyre nga anëtarësia e të njëjtit në fund të vitit 2010. Në të njëjtën kohë, përfaqësuesi i kroatëve të Kosovës nuk është ftuar t'i bashkohet KLSB-së që ekziston në komunën e Vitisë/Vitina.

Niveli i përfaqësimit të kroatëve të Kosovës në forumet tjera publike është po aq i dobët. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)²¹ vazhdon të mos ketë përfaqësim të kroatëve të Kosovës. Kur janë pyetur nga OSBE-ja se pse nuk kishte përfaqësim të kroatëve të Kosovës në KKSB, Kryetari i Komunës theksoi se kjo ftesë nuk është bërë për shkak të vështirësive në gjetjen e një përfaqësuesi nga radhët e personave të moshuar dhe të sëmurë. Përderisa nuk kroatë të Kosovës nga rajoni i Letnicës/Letnica të përfaqësuar në komisionin komunal për komunitete të Vitisë/Vitina²², është një kroat i Kosovës nga Binca/Binac. Komuna mendon se interesat e komunitetit janë të trajtuara si duhet nga pjesëtari aktual kroat i Kosovës, ndonëse kroatët në rajonin e Letnicës/Letnica pohojnë se përfaqësuesi pothuajse fare nuk ka pasur kontakt me ta dhe prandaj nuk mund t'i përcjellë si duhet nevojat dhe shqetësimet e tyre. Për shembull, në takimet e komisionit për komunitete të mbajtura më 20 tetor 2010, anëtarët kanë diskutuar një kërkesë nga udhëheqësi shqiptar i Fshatit Letnicë/Letnica që kishte të bënte me çështje të ujit, energjisë elektrike dhe infrastrukturës rrugore që pretendohet se është parashtruar në emër të të gjithë banorëve të fshatit. Megjithatë, komuniteti kroat i Kosovës në Letnicë/Letnica pohon se nuk është konsultuar për këtë kërkesë para atij takimi.

Autoritetet komunale kanë bërë pak përpjekje për integrimin e këtij komuniteti në strukturat komunale dhe rrallëherë kanë kontaktuar me ta.²³ Në korrik 2011, Kryetari i Komunës së Vitisë/Vitina ka vizituar fshatin Letnicë/Letnica për inaugurimin e projektit për furnizim me ujë. Në qershor 2011 drejtori i drejtoratit të shëndetësisë ka bërë vizitë në lidhje me zbatimin e një projekti për rehabilitimin e klinikës

²⁰ KLSB-të janë forume të zbatuara me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/54 për Kornizën dhe Parimet Udhëzuese të Shërbimit Policor të Kosovës. Qëllimi i KLSB-ve është adresimi i nevojave të sigurisë së komuniteteve lokale dhe mundësia që ato ta ngrisin zërin në çështjet policore në komunitetin e tyre.

²¹ Themelimi i KKSB-ve në Kosovë është bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/54, me qëllim të sigurojnë përfshirje më të madhe në ndërveprimet polici-komunë në nivel lokal. KKSB-të janë forume të obligueshme komunale, të kryesuar nga Kryetari i Komunës që duhet të përfshijë përfaqësues nga të gjitha komunitetet e pranishme në secilën komunë.

²² Komitetet për komunitete janë themeluar si komisione të përhershme të kuvendeve komunale me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/30 për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës. Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje lokale, i datës 15 qershor 2008, vazhdon të njej obligimin për komitet të komuniteteve në secilën komunë të Kosovës. Komitetet për komunitete janë komisione të kuvendeve komunale të cilat duhet të kenë përfaqësues të të gjitha komuniteteve në komunë, duke përfshirë ato të cilat nuk kanë vende në kuvendin komunal.

²³ Prej momentit kur OSBE-ja ka intensifikuar monitorimin e saj të kroatëve të Kosovës në rajonin e Letnicës/Letnica, ka pasur një rritje të numrit të projekteve dhe aktiviteteve nga ana e komunës. Për shembull, problemi i qenve endacakë që vërtiteshin në toka të kroatëve të Kosovës është ngritur nga përfaqësuesi serb dhe është diskutuar në KKSB në maj 2011; ekziston një projekt për përmirësimin e furnizimit me ujë në rajonin e Letnicës/Letnica dhe Shasharit/Šašare. Megjithatë, nuk është e mundur të përfundojmë nëse këto veprime deri më tani kanë përmirësuar situatën e kroatëve të Kosovës, apo do ta përmirësojnë atë në të ardhmen.

shëndetësore. Para kësaj, vizita e vetme e fundit e një zyrtari të lartë të kroatët e Kosovës në rajonin e Letnicës/Letnica ishte gjatë vizitës së Ambasadorit Kroat në shtator 2010. Megjithatë, asnjëherë gjatë këtyre vizitave zyrtarët nuk janë takuar me përfaqësues të komunitetit kroat të Kosovës. Përfundimisht, ndonëse zyra komunale për komunitete dhe kthim është themeluar në Viti/Vitina më 12 tetor 2010, ajo nuk ishte bërë funksionale deri në korrik 2011²⁴, tregues i mungesës së vullnetit politik nga radhët e administratës aktuale për promovimin e pjesëmarrjes së komuniteteve joshumicë në komunë.

4. ÇËSHTJET PRONËSORE

Pasi gati i tërë komuniteti u largua për Kroaci gjatë viteve të 1990, disa nga shtëpitë e tyre të braktisura janë uzurpuar gradualisht, fillimisht nga shqiptarët lokalë të Kosovës, e më pas në vitin 2001 gjatë dhe pas konfliktit në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë nga shqiptarët etnikë të fshatrave të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Anëtarët e komunitetit kroat të Kosovës vlerësojnë se nga afërsisht 800 shtëpi të kroatëve të Kosovës në zonën e Letnicës/Letnica, rreth 210 prej tyre janë aktualisht të zëna nga shqiptarët e Kosovës ose shqiptarët etnik me origjinë nga ish Republika Jugosllave e Maqedonisë. Gjendja e shumë shtëpive të kroatëve të Kosovës, posaçërisht e atyre të braktisura dhe atyre që shfrytëzohen për ruajtjen e bagëtisë, është e përkeqësuar dukshëm, derisa pronat e braktisura vazhdojnë të jenë shënjestër për plaçkitësit. Pavarësisht nga fushata e informimit e vitit 2005 dhe 2006 e kryer nga Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB),²⁵ e përkrahur nga Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuar për Refugjatë dhe OSBE, në përpjekje për t'i inkurajuar kroatët e zhvendosur të Kosovës që ta regjistrojnë dhe rregullojnë statusin e pronave të tyre, nuk është parashtruar asnjë kërkesë e vetme si rezultat i takimeve. Komuniteti heziton ta kërkojë riposedimin e pronave apo të ndërmerr çfarëdo veprimi tjetër në mbrojtje të pronave të tyre nga frika e kundërpërgjigjes.²⁶

Krahas raportimit për shtëpi të uzurpuara, uzurpimi dhe/ose dëmtimi i tokë së lërueshme, pemishteve dhe pyjeve rrethuese gjithashtu ka ndikuar negativisht në lirinë e lëvizjes dhe jetesën e shumë kroatëve të Kosovës nga kjo zonë. Uzurpimi i tokës së lërueshme për kullotje të bagëtisë, kryesisht nga shqiptarët nga ish republika Jugosllave e Maqedonisë, e ka parandaluar komunitetin kroat të Kosovës të përdorin tokën për qëllime bujqësore. Në raste të caktuara është kërkuar intervenimi i policisë kur kroatët e Kosovës janë përpjekur ta ndalojnë kullotjen në tokat e tyre. Meqë pronarët kroatë të Kosovës nuk kanë lista të azhurnuara të posedimit të pronave të tyre, është vështirë të dëshmohet shkelja e të drejtave pronësore në rast të përdorimit

²⁴ Ndonëse funksionale, ajo nuk mund të përshkruhet si tërësisht funksionale. Tre anëtarët e stafit nuk kanë kompjuterë dhe qasje në transport.

²⁵ DÇPB u themelua me Rregullore të UNMIK-ut nr. 1999/23 mbi themelimin e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore, dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, 15 nëntor 1999, me mandat për zgjidhjen e kërkesave pronësore që rrjedhin nga konflikti i vitit 1999 lidhu me objektet banesore. Në vitin 2006, DÇPB u trashëgua nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) me Rregullore të UNMIK-ut 2006/10 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, 4 mars 2006, me ndryshime. Prandaj, mandati i AKP-së u zgjerua për ta mbuluar gjithashtu edhe pronën e paluajtshme bujqësore dhe komerciale.

²⁶ Thënë nga përfaqësuesit e komunitetit të intervistuar nga zyrtarë të OSBE-së gjatë hulumtimit të bërë në terren për këtë raport. Shih shënimin 7, *më sipër*.

të paligjshëm apo dëmtimi. Kjo e bën të vështirë dhe pa bazë ligjore çfarëdo intervenimi policor. Prerja e paligjshme e druve frutorë në tokat e kroatëve të Kosovës në këtë zonë është gjithashtu mjaft e përhapur dhe e dobëson qëndrueshmërinë ekonomike të komunitetit. Dëmet vazhdojnë të shkaktohen përkundër intervenimeve të policisë.

4.1. Regjistrimi i pronës

Një nga pengesat kryesore për zgjidhjen e brengave të pronësisë të kroatëve të Kosovës në zonën e Letnicës/Letnica është mungesa e titujve pronësor. Për komunitetin më në moshë të kroatëve të Kosovës ndërmarrja e procedurave shpesh të ndërlikuara ligjore dhe administrative mbetet dekurajuese. Shumica e dokumenteve të pronësisë të disave prej banorëve aktual të fshatrave në zonën e Letnicës/Letnica janë të viteve 1970-ta dhe 1980-ta dhe janë në emër të prindërve apo gjyshërve të ndjerë të banuesve aktual, përderisa procedurat trashëgimore nuk janë iniciuar fare. Drejtori i zyrës së kadastrit në Viti/Vitina ia konfirmoi OSBE-së se shumica e pronësive të pronave nuk janë të përditësuara në regjistrin kadastral.²⁷ Drejtori raportoi se asnjë kroat i Kosovës nga zona e Letnicës/Letnica nuk ka kërkuar ta regjistrojë pronën dhe ai e këshilloi komunitetin që të parashtronte kërkesa për regjistrimin e pronave të tyre në zyrën e kadastrit në Viti/Vitina, duke u zotuar për përkrahjen dhe ndihmën e tij në këtë proces. Pas këtij zotimi, OSBE i këshilloi anëtarët e komunitetit që t'i drejtohen zyrës dhe të fillojnë procesin e rregullimit të situatës së tyre pronësore. Pas përpjekjeve për të vepruar sipas këshillave, disa kroatë të Kosovës raportuan në OSBE për qëndrimin jo-ndihmues të disa zyrtarëve të kadastrit, duke përfshirë rastet kur kërkesat e tyre ishin refuzuar gojarisht aty-për-aty pa ndonjë sqarim të duhur. Sipas pohimeve të përfaqësuesve të komunitetit, një zyrtar i kadastrit i ka grisur dokumentet pronësore para një të moshuari kroat të Kosovës me pohimin se janë të pavlefshme. Informacioni lidhur me incidentin e pohuar u përhap shpejt në mesin e komunitetit, duke i dekurajuar ata më tej që t'i drejtohen zyrës dhe të përpiqen t'i regjistrojnë pronat e tyre. Pengesa përfundimtare dhe fundamentale për regjistrimin e pronave të kroatëve të Kosovës në zonë mbetet kostoja e një procesi të tillë, e cila mund të arrijë shumë prej 100 Euro nëse nevojitet të bëhet matja gjeometrike. Për shkak të pamundësisë së tyre për t'i mbuluar shpenzimet, disa anëtarë të komunitetit hoqën dorë nga procesi kur autoritetet iu kërkuar një shumë të tillë.

²⁷ Për shembull, në tetor 2009 autoritetet lokale lëshuan një vendim për ta rrënuar një shtëpi të një kroati të Kosovës në fshatin Letnicë/Letnica, për shkak të uzurpimit të pohuar të pronës publike. Inspektorati komunal në Viti/Vitina e urdhëroi kroatin e Kosovës që ta lirojë pronën vullnetarisht. Pronari i shtëpisë parashtroi ankesë në Agjencinë Kosovare të Kadastrit, e cila e rikonfirmoi vendimin origjinal. Si pasojë, me qëllim të parandalimit të rrënimit të shtëpisë, pronari i saj kërkoi nga Gjykata Komunale të nxjerrë një masë të përkohshme. Kështu, gjykata kërkoi nga komuna që të ndalojë shkatërrimin e shtëpisë. Duket se komuna u mbështet në të dhënat jo të plota kadastrale, prandaj nuk e njohu listën poseduese të kroatit të Kosovës të viteve të 1990-ta. Si pasojë, pronari i shtëpisë parashtroi padi në Gjykatën Supreme për anulim të vendimit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, të cekur më lartë, e cila ende është në pritje për t'u zgjidhur. Ky rast nuk e ka ngritur besimin e komunitetit në institucionet lokale ose lehtësuar frustrimin e tyre në lidhje me çështjet pronësore.

4.2. Administrimi i pronës

Aktivitetet e DÇPB-së dhe më vonë të Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) për ta adresuar problemin e uzurpimit të paligjshëm të pronës së kroatëve të Kosovës në këtë zonë kanë sjell shumë pak të mira për komunitetin. Në fillim të vitit 2000, DÇPB bëri një vlerësim të pronave në fshatrat Letnicë/Letnica, Shashar/Šašare dhe Vrnaokolo/Vranikollë²⁸ dhe nga rreth 800 shtëpi të braktisura i mori vetëm 150 sosh nën administrim, nga të cilat vetëm disa u vlerësuan si të banueshme dhe u përfshin në skemën e qiradhënies.²⁹ Pjesa e mbetur e shtëpive të braktisura dhe të uzurpuara në tre fshatrat nuk ishte nën mandatin e DÇPB-së për shkak të faktit se ishin braktisur para konfliktit të vitit 1999. Përkundër klasifikimit si të pabanueshme, disa nga 150 shtëpitë nën administrim të DÇPB-së janë uzurpuar gradualisht. DÇPB, e më vonë edhe AKP, e kanë toleruar këtë uzurpim duke u bazuar në gjendjen e cënueshme socio-ekonomike të uzurpuesve. Gjithashtu, ekziston një argument i përgjithshëm që deri atëherë kur pronarët e vërtetë parashtronë kërkesë për riposeditim, uzurpuesit i ruajnë pronat, të cilat përndryshe do të bëheshin të pariparueshme. Megjithatë, në disa raste AKP ka ndërmarrë procedura kundër uzurpuesve të paligjshëm. Në vitin 2008 dhe 2009, AKP i referoi tri raste për ndjekje kundër qiramarrësve që jetonin në shtëpi të kroatëve të Kosovës, të cilët i riuzurpuan pronat në mënyrë të paligjshme pasi ishin dëbuar për mos pagesë të qirasë. Në një rast, uzurpuesi ishte gjobitur me 150 Euro dhe i është lejuar të vazhdojë qëndrimin në pronë. Në rastin e dytë, deri në gusht të vitit 2001 gjykimi nuk kishte filluar, e në rastin e tretë gjykimi është në pritje për të filluar. Moscaktimi i menjëhershëm i datës së gjykimit është shkelje e ligjit.³⁰

Në mars 2009, AKP e bëri një vlerësim të banueshmërisë dhe potencialit për qiradhënie të 156 shtëpive nën administrim të saj. Si rezultat i kësaj, 137 prona u klasifikuan si të pabanueshme apo të papërshtatshme për qiradhënie dhe rrjedhimisht janë hequr nga administrimi i AKP-së. Veç kësaj, në bashkëpunim me zyrën e kadastrit në Viti/Vitina, AKP i ka gjetur pronarët e 17 shtëpive nga të cilat 13 tashmë ishin shitur nga ata. Dy shtëpi në administrim të AKP-së janë në proces të shitjes, derisa për statusin e njëres shtëpi AKP nuk ofroi informacione. Informacionet e siguruar nga AKP tregojnë se një numër i kroatëve të Kosovës që më parë kanë jetuar në zonën e Letnicës/Letnica tani po i shesin shtëpitë e tyre, që sugjerojnë se ata nuk mendojnë të kthehen.

²⁸ Sipas një përfaqësuesi të zyrës rajonale të AKP-së në Gjilan, Vrnaokolo/Vranikolla dhe Vërnezi/Vrnez janë fshatra të lidhura fizikisht dhe DÇPB mund t'i ketë konsideruar ato si një fshat të vetëm; megjithatë, është e paqartë përse nuk kishte vlerësim në Vërnez/Vrnez.

²⁹ Në mesin e detyrave tjera, AKP (më parë DÇPB) e mbikëqyrë qiradhënien e pronave të braktisura, duke menaxhuar me një skemë të qiradhënies për pronat nën administrim të saj. Kjo skemë ia mundëson bartësit të zhvendosur të së drejtës pronësore të marrë një të ardhur fikse nga prona duke e autorizuar AKP-në ta jep atë me qira deri kur ai/ajo të vendos ta shfrytëzojë pronën sipas dëshirës. Neni 1.1(b) i Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23 mbi themelimin e Drejtorisë për Çështje Pronësore Banesore dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, 15 nëntor 1999. Skema e qiradhënies u bë plotësisht funksionale në vitin 2006.

³⁰ Sipas nenit 466(2) të Kodi të Procedurës Penale të Kosovës, pasi t'i jetë dorëzuar propozim-akuza të pandehurit, " gjyqtari [...] menjëherë cakton shqyrtimin gjyqësor". Nga këto dy raste të pazgjdhura, shqyrtimi gjyqësor ende nuk është caktuar në njërin prej tyre. Në tjetrin caktimi i shqyrtimit është pritur deri sa është caktuar një datë për 16 gusht 2011. Sidoqoftë, ai përsëri është shtyrë për shkak të mosparaqitjes së të pandehurit në gjykatë.

5. SIGURIA DHE LIRIA E LËVIZJES

Situata e sigurisë e kroatëve të Kosovës që jetojnë në rajonin e Gjilanit/Gnjilane ka mbetur komplekse dhe e brishtë që nga konflikti i vitit 1999, me një ndjenjë të perceptuar të pasigurisë në mesin e komunitetit. Incidente të sigurisë ndërmjet uzurpuesve të pohuar të paligjshëm të shtëpive dhe tokave të lërueshme dhe kroatëve të Kosovës që janë përpjekur t'i parandalojnë të tilla uzurpime e kanë bërë të nevojshëm intervenimin e policisë. Megjithatë, meqë kroatët e Kosovës nuk janë në gjendje ta dëshmojnë uzurpimin e paligjshëm, policia përgjigjet në këto raste vetëm si prishje të rendit dhe qetësisë publike, duke e përforcuar ndenjen e mospërfilljes institucionale që është e përhapur në mesin e komunitetit.

Kroatët e Kosovës që jetojnë në Letnicë/Letnica në përgjithësi ndihen të lirë të lëvizin nëpër fshat, derisa ata që jetojnë në Shashar/Šašare, Vrnjavokolo/Vërnavokollë, dhe Vrnez/Vërnez pohojnë të kenë qenë cak i disa incidenteve të ngacmimit fizik dhe verbal që e ka kufizuar lirinë e lëvizjes së tyre nëpër fshat. Megjithatë, rrallë herë ndodhë që komuniteti të shkojë në zonat ku banon komuniteti shumicë shqiptar i Kosovës. Për shembull, shumica e banorëve kroatë të Kosovës të intervistuar në tetor 2010 thanë se nuk guxojnë të shkojnë vetëm tek dy varrezat katolike në fshatin Shashar/Šašare, të cilat janë dëmtuar disa herë nga kryerës të panjohur. Një pengesë tjetër për lirinë e lëvizjes që është raportuar nga komuniteti është numri i madh i qenve të barinjve shqiptarë të Kosovës dhe shqiptarëve etnik nga IRJM, të cilët shpesh brezhin nëpër zonat ku banojnë kroatët e Kosovës. Frika se mos sulmohen nga qentë shpesh ua pamundëson anëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës qasjen në tokat dhe pemishtet e tyre.

Incidente të rënda të sigurisë që kanë ndodhur në vitin 2010 përfshijnë një sulm fizik ndaj një kroati të Kosovës nga një shqiptar etnik nga IRJM në Shashar/Šašare më 30 qershor 2010. Policia e arrestoi të dyshuarin, i cili u lirua pas konsultimeve me prokurorin dhe rasti iu adresua Gjykatës Komunale në Viti/Vitina. Më pas, ai u shpall fajtor nga gjykata për shkaktim të lëndimeve trupore dhe u dënua me një muaj burgim. Kroati i Kosovës i përmendur më sipër dhe bashkëshortja e tij pohojnë të kenë cak i sulmeve të të njëjtit individ në vitin 2009 dhe në janar të vitit 2010. Ai e ka uzurpuar në mënyrë të paligjshme një shtëpi të një kroati të Kosovës në afërsi të familjes në fjalë dhe që nga ajo kohë ai e ka kultivuar tokën e tyre në mënyrë të paligjshme dhe e ka shfrytëzuar për kullotje të bagëtisë.

Banorët kroatë të Kosovës të intervistuar për këtë raport theksuan që incidentet e ngacmimit, frikësimit dhe sulmeve fizike të rastit kundër komunitetit të tyre ndodhin vazhdimisht, duke e minuar lirinë e lëvizjes dhe sigurinë e komunitetit. Ata gjithashtu raportojnë se shumica e incidenteve përfshijnë uzurpuesit e paligjshëm të pronave të kroatëve të Kosovës. Megjithatë, shumica e incidenteve të ngacmimit verbal dhe fizik mbeten të pa raportuara në polici, meqë, ashtu siç pohon komuniteti kroat i Kosovës, frikësohen nga ndonjë kundërpërgjigje e mundshme nga kryerësit. Zyrtarët e policisë së Kosovës në rajon e pranojnë se janë të vetëdijshëm për problemet në zonat e komunës të banuara me kroatë të Kosovës. Megjithatë, kjo nuk ka çuar në përmirësim të situatës. Komuniteti i kroatëve të Kosovës gjithashtu e ka shfaqur pakënaqësi për numrin dhe shpeshësinë e patrullimeve në zonat ku ata banojnë, posaçërisht gjatë orëve të vona.

Përdhosja e përsëritur e varrezave katolike të kroatëve të Kosovës në fshatin Shashar/Šašare ka pasur një ndikim të prekshëm në perceptimin e sigurisë nga komuniteti. Rasti më i fundit u raportua më 16 qershor 2010, kur një kroat i Kosovës banor i fshatit e ka njoftuar policinë për dëmin e shkaktuar në të gjitha dritaret e faltores së kishës dhe në disa gurë varresh. Ndonëse kryerësit e kësaj vepre nuk janë kapur ende, përgjigja e komunës në këtë incident ishte shumë pozitive. Pas një vizite në lokacion, kryetari i komunës zotoi mjete komunale për rregullimin e dëmeve të shkaktuara si dhe rrethojën e varrezave. Sipas anëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës, një incident i llojit tjetër, prerja e paligjshme e pyjeve e shoqëruar me të shtëna të armëve, ndodh shpesh gjatë natës. Komuniteti i percepton këto incidente si frikësime, duke i lavdëruar masat e fundit të adoptuara nga policia e Kosovës për t'i vënë pikë kësaj praktike.³¹

Mungesa e perceptuar e sigurisë dhe lirisë së lëvizjes nga komuniteti i kroatëve të Kosovës në zonën e Letnicës/Letnica më tej forcohet nga fakti se nuk ka kroatë të Kosovës të punësuar në stacionin policor në Viti/Vitina.³² Zyrtarët komunalë nuk kanë dënuar publikisht apo zbatuar aktivitete të informimit për komunitetin e prekur pas incidenteve të raportuara të sigurisë. Për më tepër, mungesa e një përfaqësuesi kroat të Kosovës në KKSB në Viti/Vitina, siç u tha në Pjesën 3 më sipër, vazhdon të minojë mundësinë e komunitetit për t'i adresuar brengat e tyre drejtpërdrejt te hisedarët. Kjo mund të sqarohet përse pas sulmit në Shashar/Šašare më 30 qershor 2010, incidenti që ndodhi nuk u përmend fare gjatë takimit të KKSB-së së Vitisë/Vitina që u mbajt dy javë më vonë.

Përfundimisht, një tjetër faktor kontribuues në perceptimin e izolimit dhe ndikimit negativ në perceptimin e sigurisë të komunitetit kroat të Kosovës është qasja shumë e kufizuar në shërbimet e telekomunikimit. Nuk ka telefoni fikse në zonat e banuara nga kroatët e Kosovës. Shumica e anëtarëve të komunitetit nuk kanë mundësi të blejnë një telefon celular, ndërsa ata që kanë mundësi të blejnë një të tillë kanë pranim të dobët të sinjalit nga vetëm një operator i telefonisë mobile të Kosovës. Kjo ua vështirëson njerëzve raportimin e incidenteve në polici, ose kërkimin e ndihmës kur është e nevojshme.

6. PËRFUNDIM

Gjetjet e këtij raporti e dokumentojnë situatën e komunitetit kroat të Kosovës në komunën e Vitisë/Vitina, e cila karakterizohet me kushte të pasigurta sociale-ekonomike, prani të çështjeve pronësore komplekse dhe të pazgjidhura, brenga të vazhdueshme të sigurisë, mospërfillje të perceptuar dhe/ose të vërtetë institucionale, si dhe me mungesë të pjesëmarrjes në çështjet publike që ka kontribuar në krijimin e një ndjenje të theksuar të izolimit në mesin e komunitetit. Cënueshmëria e skajshme e komunitetit të kroatëve më të moshuar të Kosovës në komunën e Vitisë/Vitina kërkon veprim të menjëhershëm të autoriteteve lokale për të siguruar qasje të barabartë në shërbimet komunale dhe ato publike.

³¹ Plani operacional i Policisë së Kosovës përfshin konfiskimin druve të zjarrit dhe mjetit transportues me rastin e ndalimit të një drupreres të paligjshëm të supozuar, masë kjo që zbatohet vetëm në këtë zonë.

³² Ndonëse disa kroatë të Kosovës nga Janjeva/Janjevo (rajoni Prishtinë/Priština) shërbejnë si zyrtarë në pjesë tjera të Kosovës.

Çështjet e vjetra të pronës që e prekin komunitetin, duke përfshirë mungesën e titujve adekuat të pronës, regjistrat e pa përditësuar komunal të kadastrit, si dhe uzurpimi i paligjshëm i shtëpive dhe tokës së lërueshme, vazhdojnë të minojnë gëzimin e tyre të së drejtës pronësore. Për shkak të kompleksitetit, ndjeshmërisë dhe vëllimit të çështjeve të pazgjidhura pronësore, kroatët e moshuar të Kosovës të kësaj komune nuk kanë mundësi të merren me ato pa ndonjë ndihmë. Shumica në komunitet kanë nevojë për asistencë ligjore lidhur me pronën dhe asistencë administrative, duke përfshirë edhe ndihmën në identifikimin e bartësve të së drejtës pronësore dhe regjistrimin e të drejtave të tyre pronësore në regjistrin kadastral, si dhe kanë nevojë për këshilla dhe përfaqësim ligjor kur të procedohen rastet.

Brenga e sigurisë e komunitetit mbetet një nga pengesat kryesore për pjesëmarrjen e tyre efektive në jetën publike. Ndonëse natyra e incidenteve të pa raportuara të sigurisë që e prekin komunitetin e bën sfidues çdo vlerësim faktik të OSBE-së, frika në mesin e këtij komuniteti të cenueshëm dhe të izoluar ka një ndikim të prekshëm në lirinë e lëvizjes së tyre dhe në gëzimin e të drejtave dhe lirive.

Cikli i mospërfillje institucionale, izolimit të perceptuar apo aktual, mungesës së pjesëmarrjes dhe mospërfilljes së mëtejshme mund të ndërpritet vetëm përmes intervenimit të shpejtë dhe efektiv nga autoritetet lokale për ta siguruar komunitetin dhe për t'i adresuar brengat e tyre. Autoritetet komunale do të duhej ta marrin përgjegjësinë për mirëqenien e komunitetit kroat të Kosovës në komunën e Vitisë/Vitina dhe t'i krijojnë kushtet për zgjidhje të qëndrueshme për brengat e tyre më urgjente.

7. REKOMANDIME

Për komunën e Vitisë/Vitina:

- Të sigurojë përfaqësim adekuat të interesave të komunitetit kroat të Kosovës në degën ekzekutive dhe legislative të komunës.
- Të sigurojë themelimin, funksionalitetin dhe përputhshmërinë e të gjitha mekanizmave të detyrueshme relevante, duke përfshirë këtu zyrën komunale për komunitete dhe kthim, këshillave komunale për siguri në bashkësi dhe komitetin për komunitete në mënyrë që të mbrojnë dhe promovojë të drejtat e komuniteteve, si dhe të përfshijë përfaqësimin e komunitetit kroat të Kosovës në ato mekanizma.
- Të zhvillojë aktivitete të rregullta të informimit tek komuniteti përmes zyrës komunale për komunitete dhe kthim për ta ngritur besimin ndaj institucioneve lokale.
- Të garantojë qasje të barabartë në shërbime komunale, duke përfshirë qasjen në kujdes shëndetësor dhe shërbime të kujdesit shtëpiak, si dhe shërbime publike dhe t'i përfshijë zonat e banuara me kroatë të Kosovës në projektet e ardhshme të infrastrukturës në mënyrë që të sigurohet qasja e duhur në ujë për të gjithë banorët e fshatrave.
- Të respektohet kërkesa për gjuhët nga të gjithë zyrtarët komunalë kur kanë të bëjnë me komunitetet joshumicë, duke përfshirë kroatët e Kosovës. Të vendosen shenja në dy gjuhët në të gjitha zyrrat publike dhe kur është e

nevojshme të sigurohet qasja në personel që flet gjuhën serbe ose të sigurohet përkthyesi.

- Të lehtësojë zgjidhje të qëndrueshme në zhvendosjen e komunitetit, duke përfshirë organizimin e vizitave shko-dhe-shih dhe shko-dhe-informo, përmes zyrës komunale për komunitete dhe kthim.
- Të promovojë zgjidhje të qëndrueshme në çështjet pronësore të komunitetit duke iu ofruar përkrahje ligjore dhe administrative atyre që dëshirojnë t'i rregullojnë dhe/ose kërkojnë të drejtat e tyre pronësore dhe duke i hequr apo ulur konsiderueshëm taksat administrative për ata kroatë të Kosovës që nuk kanë mundësi të paguajnë.
- Të përgjigjen në incidentet e sigurisë duke lëshuar deklarata që i dënojnë ngjarjet dhe duke kryer aktivitete informimi tek personat e prekur, si dhe duke implementuar iniciativa për ta promovuar dialogun ndërmjet kroatëve të Kosovës dhe komuniteteve tjera në komunë.

Për Qendrën për Punë Sociale në Viti/Vitina:

- Të kryejë një vlerësim të menjëhershëm dhe gjithëpërfshirës të nevojave të komunitetit dhe të zhvillojë një plan për të siguruar kujdes shtëpiak dhe lloje tjera të ndihmave sipas nevojës.

Për Policinë e Kosovës:

- Të shtojë patrullimet në atë zonë dhe të zbatojë aktivitete specifike të informimit për komunitetin kroat të Kosovës.
- Të vlerësojë përshtatshmërinë e themelimit të një nënstacioni në Letnicë/Letnica për t'i mbuluar katër fshatrat e banuara me kroatë të Kosovës.
- Të konsiderojë rivendosjen e policëve kroatë të Kosovës në këtë zonë për ta risiguruar komunitetin.
- Të inkurajojë përfaqësimin e komunitetit kroat i Kosovës në Komitetin ekzistues Lokal për Siguri Publike në komunën e Vitisë/Vitina.